



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. nr. 671/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare, Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik NTP "Air Tours"- Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material hidrosanitari - ndriçim-elektrikë etj, për Administratë, QKMF dhe shkolla", me nr. 624-22-3122-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna Suharekë, me datën 03.02.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik NTP "Air Tours"- Suharekë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 17. 11. 2022 me numër protokolli 671/2022 për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material hidrosanitari - ndriçim-elektrikë etj, për Administratë, QKMF dhe shkolla", me nr. 624-22-3122-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna Suharekë.

2. **Anulohet**, vendimi i AK- KK Suharekë për dhënie të kontratës për aktivitetin e lartcekur të prokurimit dhe lënda kthehet në rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

4. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NTP "Air Tours"- Suharekë, aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A r s y e t i m**

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Komuna e Suharekës në cilësi të autoritetit kontraktues me datën 25 prill 2022 ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material hidrosanitari - ndriçim-elektrikë etj, për Administratë, QKMF dhe shkolla", me nr. 624-22-3122-1 -1 -1. AK me datën 27. 09. 2022 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës.

Kërkesa për rishqyrtim është bërë 07. 11. 2022 ndërsa vendimi për refuzim është i datës 09. 11. 2022.

Të pakënaqur me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim OE i cekur si më lartë ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 17. 11. 2022 nr. 671/22 (numër i protokollit).

Me rastin e vlerësimit paraprak, Paneli konstatoi se Ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (më tej: LPP), sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e këtij Organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim me nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 01. 12. 2022 ka rekomanduar që:

- të aprovohet ankesa e OE ankues, si dhe
- të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - Komuna Suhareke, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizim (kornizë 36 muaj) me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, pas ri vlerësimit të ofertave.

Fillimisht po sqarojmë se kjo procedurë e prokurimit ka qene objekt shqyrtimi ne OSHP. OE tani i rekomanduar për dhënie të kontratës, vlerësimit fillestar të ofertave e ka kontestuar, rrjedhimisht është nxjerr raportit i ekspertizës me nr. 264/22, ku ishte kontestuar arsyetimi i eliminimit të OE tani të rekomanduar.

Përgjigje në pretendimet ankimore (neni 113): Tani pas ri vlerësimit të ofertave, pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë, kundër propozimit për dhënie të kontratës, konkretisht kontestohet oferta e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës: Pretendohet se, dëshmitë e prezantuar për projektet e realizuara ne emër të liderit të grupit janë fiktive dhe Oferta financiare çmimet për pozicione të disa nga produktet janë jo normalisht të ulëta apo çmime manipulative. Sa i përket pretendimit të pare ankimore lidhur me projektet e realizuara, përkatësisht vërtetësinë e tyre, eksperti shqyrtues nuk ka kapacitet teknik dhe profesional për vërtetësinë e tyre. Ne përmes raportit paraprak të potencuar me larte kemi sqaruar se ne emër të anëtarit të grupit të OE të rekomanduar tani për dhënie janë prezantuar dëshmi përmes të cilave e mbulohet kërkesa dhe vlera e projekteve sipas kërkesës së AK-se,

Përderisa sa i përket pretendimit tjetër ankimore, lidhur me pozicionet e ofertës financiare, sqarojmë se AK- përgjatë, procesit të vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarim shtese për disa nga pozicionet e paramanës.

Shembull: poz. 15, 16, 58, 68 etj. OE i rekomanduar për dhënie, përmes përgjegjësisë ka dhënë sqarime, ku për disa nga pozicionet ka prezantuar edhe disa nga faturat e furnitorit, dëshmi të cilat AK - Komuna Suhareke i ka trajtuar si të mirëqena.

Megjithatë, parashtruesi i ankesës, përmes ankesës ka kontestuar edhe pozicione tjera, tek materialet e bravarisë, siç janë pozicionet nga 8 deri 11, ku janë ofruar çmime kontradiktore sipas pozicioneve.

Shembull: Ne pozicionin 8 "Bravë për dyer pvc është dhen çmimi prej 6 €, poz 9 "Bravë për dyer al" çmimi 0.20 € ndërsa poz 10 "Bravë komplet për dyer pvc" 1.20 €. Pozicioni 45 "varëse për rroba" çmimi 0.10€ etj.

- AK- Komuna Suharekë, përgjatë procesit të ri vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjitha pozicionet e ofertës financiare të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, siç parashihet me dispozitat e nenit 61, par 1 të LPP-se " Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Prandaj, propozimi ynë për AK-Komuna Suhareke edhe të lenden ta kthej ne ri vlerësim me qellim që ti trajtoj edhe çmimet të cilat kontestohen nga parashtruesi i ankesës apo edhe çmimet për pozicione tjera të cilat mund të jene si çmime jo - normalisht të ulëta.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertëve shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

- *Konstatimet dhe përfundimet e Panelit Shqyrtues* -

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron, se ky aktivitet i prokurimit është trajtuar edhe më parë në OSHP.

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me ofertën e OE te rekomanduar për dhënie të kontratë, ku OE ankues pretendon se dëshmitë e prezantuara për projektet e realizuara në emër të liderit të grupit janë fiktive dhe oferta financiare çmimet për pozicione të disa nga produktet janë jo normalisht të ulëta apo çmime manipulative.

Sa i përket pretendimit të parë ankimore lidhur me projektet e realizuara, përkatësisht vërtetësinë e tyre, Paneli shqyrtues nuk ka kapacitet teknik dhe profesional për vërtetësinë e tyre. Në emër të anëtarit të grupit të OE te rekomanduar tani për dhënie janë prezantuar dëshmi përmes të cilave e mbulohet kërkesa dhe vlera e projekteve sipas kërkesës së AK-se.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli konstatoi në vijim se, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër në relacion me pretendimet ankimore, PSH konstaton se AK ka vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 59, 60 dhe 61 të LPP. AK sa i përket çmimeve jo-normalisht të ulët ka kërkuar sqarime nga OE i cili e ka rekomanduar për kontratë dhe i njëjti i ka dërguar sqarimet dhe përgjigjet të cilat për AK kanë qenë të mirëqena. Këto sqarime dhe shpjegime sa i përket çmimeve të pozicioneve të cilat kanë qenë të ulëta OE i ka ofruar argumentet e tij përmes faturave.

Lidhur me çështjen e ngritur, objekt i kësaj ankese, vlen të theksohet se qëllimi primar i hartimit të legjislacionit që përkufizon dhe përcakton procedurat e çmimeve jo-normalisht të ulëta është devijimi i mundësive të manipulimit të çmimeve përmes ofertave jo-korrekte me çmime jo të tregut, kështu si pasojë duke mundësuar diskriminimin e OE-ve të cilët konkurrojnë me çmime tregu e të tilla të zakonshme, gjë që nga praktika e deritanishme këto çështje janë hasur tek kontratat kornizë, e sidomos kur sasi të indikative nuk janë të ditura dhe ofertohej me sasi 1 për

secilin pozicion, me poentim dhe peshim të çmimeve ku caktohet pesha e vlerësimit të tenderit, etj.

Paneli Shqyrtues konstaton se duke u bazuar në të dhënat e këtij aktiviteti, ky aktivitet është i llojit të procedurës së hapur, dhe me qenë se kemi sasi indikative për secilin pozicion duke ditur sasi të produkteve që ofertohej, PSH konstaton se sqarimet e ofruara nga OE ankues arsyetojnë ofertën e tij në aspektin përmbajtësor, dhe AK në këtë rast është dashur të konsiderojë këto rrethana, duke pasur parasysh instrumentet ligjore që mund ti përdorë para dhe përgjatë implementimit të kontratës, siç janë rritja e sigurimit të ekzekutimit sipas RRUOPP, Neni 30.4, menaxhimi i saj sipas kriterëve standarde dhe sasive të përcaktuara paraprakisht, e poashtu duhet në këtë rast marrim parasysh se OE ankues qëndron mbrapa ofertës së tij duke u zotuar përmbushjen e saj si dhe duke sqaruar se artikujt e njejtë veçse posedohen nga ta, përveç kësaj duhet konsideruar edhe deklaratat e dorëzuara me ofertën e edhe sanksionet që mund të mirren në rast të mos-përmbushjes së kontratës.

Duke u bazuar nga të gjitha faktet, arsyet dhe gjendjen faktike që u përshkrua si më sipër, PSH konstaton se pretendimi ankimor klasifikohet si i bazuar, dhe se deri tek vendimmarrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi është ardhur gjithashtu duke konsideruar tiparet kryesore të LPP-së, që janë ekonomiciteti, diskriminimi dhe kursimi i buxhetit të shtetit, duke qenë se oferta e OE ankues përmban çmimin më të lirë ndërsa për kontratë është rekomanduar oferta me çmimin më të shtrenjtë.

Paneli shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike lidhur me nenin 60 të LPP. Po ashtu AK lidhur me këtë aktivitet të vë në zbatim edhe neni 63 citur *Siguria e Ekzekutimit Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik të cilit i është dhënë një kontratë që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së tillë nëse: (i) kontrata e tillë është kontratë e punëve; (ii) kontrata e tillë është kontratë e shërbimeve për krijimin e programeve kompjuterike, ose; (iii) ekziston rreziku se thyerja e kontratës së tillë do të shkaktojë dëme substanciale autoritetit kontraktues dhe/ose mund të kërkojë që autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë.*

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkuara si më sipër dhe provat e administruara, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, konform nenit 117 të LPP.

Kryetari i Panelit Shqyrtues  
Vedat Poterqoi



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK Suharekë

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.